



Dita Kombëtare e Ardhshmërisë - Faktet më të rëndësishme shkurtimisht

Qëllimi i Ditës Kombëtare të Ardhshmërisë është të promovohet planifikimi profesional dhe jetësor i hapur dhe i pavarur nga pikëpamja e gjinisë për nxënëset dhe nxënësit. Për këtë arsye, qindra kompani, organizata, shkolla profesionale dhe universitete kanë hapur dyert e veta me rast të Ditës së Ardhshmërisë. Vajzat dhe djemtë prej klasës e pestë e deri në klasën e shtatë ftohen që t'i shoqërojnë kujdestarët në vendin e punës ose që të marrin pjesë në projekte të veçanta shumë ngacmuese. Në pajtim me devizën "ndërrimi i anëve", ata zbulojnë profesione, fusha të punës dhe karriera që janë atipike nga pikëpamja gjinore, në mënyrë që shumë mundësi të hapen para syve të tyre.

A keni edhe ju një vajzë apo një djalë prej klasës e pestë e deri në klasën e shtatë? Nëse është ashtu, përdorni këtë mundësi. Ka mënyra të ndryshme për të marrë pjesë në Ditën e Ardhshmërisë:

1. Programi bazë: Vajzat dhe djemtë shoqërohen një kujdestar në vendin e punës.

Shoqëruesi zgjidhet në Qendër sipas sistemit të ndërrimit të anëve. Megjithatë, ka variacione të shumta, duke përfshirë.:

- Vajzat shoqërohen nga baballarët e vet, djemtë nga nënat (ose një kujdestar tjetër);
- Vajzat shoqërojnë një person, i cili punon në një profesion me një përqindje të madhe burrash, ndërsa djemtë shoqërojnë një person, i cili punon në një profesion me një përqindje të madhe grash.

2. Projektet e veçanta: Vajzat dhe djemtë do të marrin pjesë në një projekt të veçantë sipas zgjedhjes së tyre.

Shumë kompani, organizata, shkolla profesionale dhe universitete organizojnë programe të veçanta me Ditën e Ardhshmërisë dhe ftojnë vajza dhe djem që të zbulojnë fushat e punës që janë atipike nga pikëpamja gjinore. Në qoftë se fëmija juaj dëshiron të marrë pjesë në një projekt të veçantë, ju mund të veproni siç vijon:

- Informacione të përgjithshme lidhur me projektet mund të gjenden në: "[Projektet e veçanta për vajzat](#)" ose "[Projektet e veçanta për djemtë](#)".
- Me link-un e mëposhtëm, ju mund të regjistroni bijën ose birin tuaj në një projekt të veçantë në kantonin e banimit: <http://www.nationalerzukunftstag.ch/de/angebote/>

Udhëzimet praktike për pjesëmarrjen:

Në kompaninë tuaj

Pyetni në kompaninë tuaj, nëse ka mundësi që ju të vini në punë me fëmijën tuaj me rast të Ditës së Ardhshmërisë dhe, pas kësaj, i informoni kolegët e punës. Në shumë kompani, Dita e Ardhshmërisë është vetëm pjesë e programit vjetor.

Në shkollë

Pyetni në shkollë nëse klasa ka planifikuar të marrë pjesë në Ditën e Ardhshmërisë. Nëse jo, ju mund të paraqitni një kërkesë leje për fëmijën tuaj. Në varësi nga kantoni, [ekzistojnë kushte të ndryshme të pjesëmarrjes](#). Në rast të fëmijëve, që nuk marrin pjesë në Ditën e Ardhshmërisë dhe mbeten në shkollë, ka projekte të brendshme në kuadër të shkollës.

- Këtu mund të gjeni kërkesën e lejës:
http://www.nationalerzukunftstag.ch/fileadmin/files/Dispensationsformular_18.pdf

Organizimi i ditës projektit

Ju duhet të mendoni, para Ditës së Ardhshmërisë, se cila është puna që fëmija juaj mund ta kryejë në mënyrë të pavarur. Nuk ka gjë më zbavitëse sesa bashkëpunimi! Mund të bëhet fjalë për puna të vogla, si për shembull, shpërndarja e postës, ngjitja e pullave, kopjimi, blerja e mezeve dhe furnizimi i veglave. Një **listë e plotë** për organizimin e ditës është e disponueshme [këtu](#).

Intervista

Pyetni një kolege ose koleg në vendin e punës, nëse ajo ose ai është i gatshëm/e gatshme të intervistohet nga fëmija juaj. Me rast të Ditës së Ardhshmërisë, vajzat dhe djemtë mësojnë se sa e shumëanshme është gama e profesioneve të mundshme. Prandaj, ju duhet të zgjidhni posaçërisht një person, i cili merret me një profesion të ri dhe të panjohur nga pikëpamja e fëmijës suaj. Klikoni këtu [për të shkarkuar shabllonin e intervistës](#).

Pyetëtori për Ditën e Ardhmërisë

Pas ditës së projektit, siguroheni që fëmija juaj ka plotësuar [Pyetëtorin për Ditën e Ardhmërisë](#) dhe e dërgoni në [Zyrën e Ditës së Ardhshmërisë](#).